

# KOSOVARJA

Ballina: Adelina Spahija



**KËNGËTARËT MARRIN  
AQ PARA NË MINUTË,  
SA PUNËTORI NË DITË**

**INXHE, SA E KE  
“ÇMIMIN”**

**A JETOHET GJITHMONË  
ME NJË GRUA**

**A DO ME MBET  
ÇIFT PA U NDA**

**ADELINA SPAHIJA,  
YLLI I MUZIKËS  
QË NUK BËN “FILMA”**

**15 MIJË KILOMETRA  
ME BIÇIKLETË PËR  
TË TAKUAR  
TË DASHURËN**

**41 VJET JETOVA  
PËR NJË DITË**





SHERWOOD  
Resorts and Hotels



GREENWOOD  
Resorts and Hotels

*feel the legend*



ANTALYA | TÜRKİYE



SHERWOOD  
Gölköy Resort



SHERWOOD  
Gölköy Lara



SHERWOOD  
Dünya Resort



SHERWOOD  
Pamukkale



3UE  
Türkiye  
Seyahat



GREENWOOD  
Kızıllı Resort



GREENWOOD  
Kızıllı Resort

[sherwoodhotels.com.tr](http://sherwoodhotels.com.tr) | [greenwoodhotels.com.tr](http://greenwoodhotels.com.tr)

+90 444 86 07

# Adelina Spahija, ylli i muzikës që nuk bën “filma”

*E bukura e skenës muzikore, këngëtarja Adelina Spahija, është rikthyer me një këngë dhe videoklip që meritojnë notën 10. “Filma-filma” titullohet projekti i ri i këngëtares, i realizuar me shumë dashuri e përkushtim. Adelina është këngëtarja me potencial dhe që lë gjurmë me muzikën dhe paraqitjet e saj. Adelina në “Kosovare” rrëfen të pathënat...*





### **Adelinë, a mundesh me e përshkruar veten me tri fjalë?**

- Ambicioze, korrekte, modeste. Nuk është shumë e lehtë të flasësh për veten dhe cilësitë personale, por realisht unë përpiqem shumë t'i arrij synimet e mija, por për ta bërë këtë punoj pa ndalë dhe jam përherë korrekte në çdo gjë.

### **Po, të tjerët si të përshkruajnë?**

- Punëtore, të dashur, të sjellshme.

Mendoj se kanë të drejtë në këtë përshkrim, meqë nuk ndalem së punuari dhe së bëri më të mirën për veten dhe rrethin.

Jam e dashur dhe mendoj se sillem mirë me ata që e meritojnë sjelljen dhe janë korrekt.

### **Si ndihesh sot kur thirrret emri yt?**

- Rruga drejt suksesit nuk është e lehtë, andaj ndihem krenare për rrugëtimin që e kam bërë. Nuk do të ndalem me kaq, sepse kam edhe shumë për të bërë. Një falënderim e shumë përqafime për të gjithë ata që më duan dhe suportojnë prej kohësh.

### **A ke besuar se do të kesh sukses në muzikë?**

- Po, sepse e kam njohur dhe e njohë mirë kapacitetin dhe potencialin tim.

### **Cila është kënga që të bëri të njohur?**

- Është kënga me titull "Si te motra s'ka askund", këngë me një tematikë shumë reale në kohët e sotme.

Kjo këngë u mirëprit nga publiku, andaj mendoj se është edhe një nga ato që më ka bërë më të njohur e më të dashur për masën e gjerë.

### **Dueti i ëndrrave?**

- S'di, nuk e kam menduar, por jam e hapur për bashkëpunim.

### **Çka e bënë një këngëtare të kompletuar?**

- Mendoj se është bagazhi i krijuar ndër vite. Investimi në muzikë dhe imazh duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i pandashëm.

Duhet motiv e punë e vazhdueshme për të qenë i kompletuar në botën e artit dhe muzikës.

### **Pak fjalë për projektin e fundit?**

- Kënga ime e fundit titullohet "Filma-filma" dhe është një projekt rreth të cilit kam punuar me shumë përkushtim e dashuri.

"Filma-filma" është realizuar nga kompozitori Blerim Haziri, tekstin e ka punuar Edon Sejdiu dhe jam e lumtur që është mirëpritur nga publiku.

### **Dukeni bukur, fresh dhe ndryshe.**

#### **Si erdhe deri te kjo ide?**

- Pamja është dhuratë nga Zoti. Sa i përket idesë, ishte një linjë që doja ta prezantoja, diçka moderne dhe verore.

### **Cila është pika që e synon në karrierë?**

- Si çdo artist, edhe unë pretendoj të arrij sa më lart, për çka edhe punoj pa ndalur. Dashtë Zoti të jem në pikën që dua!

### **Gjërat pa të cilat nuk e mendon jetën?**

- Pa familjen dhe pa të afërmit e mi, që i dua shumë.

### **Përtej skenës, si je?**

- Njeri si të gjithë të tjerët, duke u marrë me gjëra të përditshme dhe të zakonshme.

Modeste dhe e përkushtuar në qëllimet e mija.

Jam e dashur dhe me humor.

### **Një dëshirë?**

- Sekret.

### **Jeta private?**

- Respekt, por nuk do të doja të flisja për jetën time private.

### **Planet?**

- Kam shumë plane dhe realizimin e tyre do ta shihni në vijim. Ka mjaft surpriza.

**N. Neziri**



## Këngëtarët marrin aq para në minutë, sa punëtori në ditë!

Me sezonin e verës dhe ardhjen e bashkatdhetarëve tanë në Kosovë, organizohen edhe mbrëmje të ndryshme, dasma dhe gazmende të tjera familjare.

Dhe, për ta bërë dasmën sa më të madhe, kosovarët, ndonëse me xhepa të zbrazët, nuk hezitojnë t'i ftojnë edhe këngëtarët më të mirë.

Pagesa e një këngëtarit në një gazmend familjar sillet nga 2000-5000 euro, ndërsa koha sa këndon është afërsisht 3-4 orë.

Sipas kësaj, nëse bëjmë një llogaritje të thjeshtë dhe e llogarisim vlerën e pagesës me kohën sa këndon, del se këngëtarët tanë në Kosovë marrin mesatarisht 15 euro në minutë, që, fatkeqësisht, është sa një mëditje e një punëtorit në Kosovë!

Në këtë çmim përjashtohen bakshishet e majme, të cilët vetëm nëse ia përmendin emrin dikujt kërcet bakshishi nga 20 deri në 100 euro!

E, a ia vlen një shpenzim i tillë?

Vlerësojeni vetë...



## Kujtesa Delija, gazetarja me perspektivë

Kujtesa Delija, e cila ka studiuar në Universitetin e Prishtinës në Degën e Gazetarisë, është autore e emisionit televiziv "N'kamp me Kujtesën", emision të cilin e realizon me shumë sukses.

Mysafirët e saj janë të ndryshëm: politikanë, këngëtarë, kryetar komune, bjeshkatarë e të tjerë.

Kujt nuk i ka lënë përshtypje emisioni i saj me deputetin e LDK-së Anton Qunin, nënkryetaren e PDK-së Vlora Çitakun, nënkryetarin e LDK-së Lutfi Hazirin, politikanen Natyra Kuçin, kryetarin e komunës së Prizrenit Shaqir Totajn, dizejnatoren Blerina Kllokoqi-Rugova, ish-misin Diellza Kolgecin e shumë të tjerë?

Andaj, perspektiva e saj në gazetari, pa dyshim, s'ka të ndalur...

# PSE DISA NJERËZ I DUAM E DISA I URREJMË?!



S'e kam prej nostalgjisë, siç do më thoshin...  
Por, në kohën paraprake, jo të largët, miqtë kanë qenë të vërtetë, pa maska.  
Po ashtu, solidariteti ndaj njëri-tjetrit, për njëri – tjetrin, ka qenë për lakmi dhe që na ka mbajtur në kohë të rëndë, të zorshme...  
Jo vetëm miqtë, sot ka ndryshuar e ndërruar shumëçka.  
A pajtoheni?

\*  
Të gjithë e kemi jetën tonë. Bota ka vuajtur shumë për të arritur në këtë gjendje dhe ne duhet të kërkojmë që të organizojmë në mënyrën më të mirë, që të arrijmë të lumturën shpirtërore.  
Jetojmë, por në këtë jetë gjithmonë mungon dhe na mungon diçka. Për këtë jemi edhe në këtë jetë, që të arrijmë aty ku na plotësohet mungesa.

Dante Aligeri, në "Komedinë hyjnore", ka thënë: "Atë ditë kur njeriu do të lejojë të shfaqet dashuria e vërtetë, gjërat që duken të organizuara do bëhen rrëmujë dhe do të jenë kundërpeshë e gjithë asaj që ne e mendojmë si të drejtë, që është e vërteta".  
Bota do të bëhet e vërtetë vetëm kur njeriu do të dijë të dashurojë. Deri atëherë do të jetojmë

duke besuar se e njohim dashurinë, por pa e pyetur kurrë guximin që ta përballojmë ashtu siç është në realitet.

\*  
Mirë e kanë pasur ata që kanë thënë: Dashuria është një forcë e egër:  
Kur do të përpiqemi ta kontrollojmë - na shkatërron; Kur tentojmë ta burgosim - na bën skllëvër;  
Kur mundohemi ta kuptojmë - na lë të hutuar...

\*  
...dhe ai që thoshte: i urrej lamtumirat, sidomos në stacione, qofshin të autobusëve, të trenave, qofshin në aeroporte...  
Nuk e dua lamtumirën!

\*  
Përse i duam disa njerëz e ca të tjerë i urrejmë?!  
Koha ma imponon të bëj këto pyetje, sikur atëherë kur nënës sime ia bëja kur isha i vogël, fëmijë...  
"Kuku, o djali jem, po ku, kah, çka po t'bie në mend?"  
Pleqëria ta qon mendjen kahmos...

**Gani Dili**

## KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**  
Gani DILI

**Redaktor përgjegjës:**  
Isa ILAZI

**Menaxher:**  
Driton DILI

**Redaksia:**  
Safet Krivaça (reporter i lirë)  
Nderim Neziri (redaktor)  
Besiana Dili  
Drenushë Haredinaj  
Ardita Dili  
Edona Vllasaliu - Bajoku  
Xheneta Spahiu  
Denisa Oruqi

**Dizajni:**  
Labinot Bërbatovci

**Adresa e redaksisë:**  
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë  
**Tel:** 038 51 75 75  
**Email:** [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**  
Tel: +383 44 143 448;  
**Email:** [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)



Refugjatë çamë në kampet e Shqipërisë

# Ç'thonë të mbijetuarit çamë që përjetuan masakrat nga grekët?

*Fundi i muajit qershor për shqiptarët e Çamërisë në Greqi ishte kohë përkujtimi të masakrës së shtetit grek mbi shqiptarët e Çamërisë...*

Në qershorin e sivjetmë u bën 80 vjet nga masakrat shoviniste greke në Çamërinë shqiptare, e cila u detyrua të shpërngulej në dy drejtime: Në një anë nga Turqia e në anën tjetër nga Shqipëria.

Çamët e Greqisë u larguan nga dhuna shtetërore, por në epikën dhe tragjikën e dëbimit mbetën këngët shqipe të Çamërisë dhe herë pas herë edhe orvatjet e tyre për rikthim në atdheun e mallit.

## Ç'THOTË HALIT HOXHA, I MBIJETUARI I MASAKRËS TE "MULLIRI I MEQËS"?

Historia 80-vjeçare e tragjedisë së trishtuar çame nga grekët duket e harruar dhe e largët, por edhe sot ende jetojnë burra e gra, të cilët e kanë përjetuar tmerrin që ndodhi me ta nga grekët.

E panë me sytë e tyre se çka ndodhte te "Mulliri i Meqës", te "Jazi i beut" dhe në shumë vende që kishin emra dhe sot

ruhen akoma si toponime shqiptare.

Njëri nga ta që e përjetoi masakrën nga grekët është Halit Hoxha, i cili jeton në Tiranë.

Halit Hoxha në kohën e masakrës çame nga grekët ishte tetë vjeç. Ai mban mend se 700 shqiptarë çamë para 80 vjetësh u ekzekutuan në Paramithin nga forcat shoviniste greke.

Ai me lot në sy thotë: "Do të vdes me mall pa e parë shtëpinë në të cilën jam lindur dhe e shoh ëndërr çdo natë!".

Ndërkaq, një e mbijetuar, thotë: "Një burri, me emrin Haxhi Shehu, pasi i dogjën mjekrën me vaj, i rropën lëkurën, duke ia varur në një cengel".

Po ajo thotë se tri ditë na mbajtën neve, grave, në polici. Ishim 300 gra, prej të cilave 150 vdiqën.

E, pas 6 muajsh përmes një misioni me emrin "Egles", na nisën për në Shqipëri.

Na ndalën në fshatin Kosk të Filatit. Por, derisa arritëm në Kosk 20 gra vdiqën gjatë udhëtimit.

## AVDUL SULEJMANI, 93 VJEÇ, THOTË:

Avdul Sulejmani mban në kujtesë çka ka ndodhur në Çamëri. Familja e tij ka ecur me ditë të tëra derisa është vendosur në Fier.

Në atë kohë ai ishte 14 vjeç. Kishte parë me sy masakrat greke mbi çamët.

Vendlindja e tij quhej Varfanj, e që sot njihet me emrin Parapotamos.

"Kam arritur ta shoh shtëpinë time. Ika nga Italia me një grup gazetarësh italianë dhe e pashë nga jashtë shtëpinë, sepse ata që e posedojnë sot shtëpinë time nuk janë aty", ka dëshmuar Sulejmani për mjete të informimit.

Ndrishe prej Sulejmanit, Halit Hoxha thotë se nuk ka mundur kurrë ta shoh shtëpinë e vet. Ai ka tentuar të shkojë dy herë, por nuk është lejuar nga grekët.

"Më 2005 u nisa të shkoja me një grup çamësh ta shoh vendlindjen, por grekët më kërcënuan dhe më thanë se nëse edhe një herë tenton, ta marrim pasaportën", thotë Halit Hoxha.



# Letra që vret!

Përshëndetjet Redaksi!  
Jam 49-vjeçare, vuaj nga sëmundje e rëndë. E kam një djalë të vetëm, që ma ka falë Zoti vonë. Në atë kohë burri im vdiq aksidentalisht e më la të përballëm me djalin...  
Nuk më dhimbset vetja, sepse edhe ashtu kam pasur jetë të rëndë si te baba ashtu edhe në martesë, por nuk di çka do i bëj djalit...  
Askush nuk i ka kushtet ta rritë e të merret me të.  
Jam e sëmurë, por më shumë jam e plagosur për tim bir se si do të jetoj pa mua, si do të arrijë ta sigurojë kafshatën e gojës...

T. F., Gjakovë

**Pa hy në hollësi, Zoti ka për të gjithë. Ka edhe ilaçe për të gjithë, ashtu si mund të ketë edhe për ty.**  
**Ka bukë edhe për djalin tënd e për fëmijët tjerë të botës... Andaj, më e rëndësishmja është të shërohesh ti dhe të jetoni bashkë me të birin, derisa ta shohësh të martuar e me fëmijë.**  
**Mos e paragjyko të keqen! Jetoje jetën me dinjitet! Megjithatë, kurrë mos harro se në botë ka drama shumë më të tmerrshme njerëzore, që ndodhin edhe në vendet me të zhvilluara të botës.**  
**Pra, pakkush, për të mos thënë askush, nuk është i lumtur në jetë. E, këtë pakënaqësi njerëzore në kohën e sotme e dëshmon fakti se në çdo 40 sekonda, një njeri bën vetëvrasje në botë, apo ia merr jetën vetes, duke mos qenë i kënaqur me asgjë**

**dhe duke mos parë dritë në fund të tunelit.**

**E, kur njeriu mendon se në çdo 40 të sekonda dikush e privon veten nga jeta, duke ia marrë të drejtën vetes të jetojë, kjo tregon se sa të palumtur janë njerëzit që nuk shohin arsye për të jetuar.**

**Ndërkaq, sa i përket sigurisë jetësore, askush nuk jemi të mbrojtur as nuk kemi garanci se do jetojmë deri nesër.**

**Shpërfaqja e cilësdo sëmundje është vetëm një alarm që bëhet i ditur për çdo kënd se në moment është pacient, por pak kush di se për çdo ditë në trupin e njeriut vdesin rreth 36 milionë qeliza, që kanë të bëjnë me ndryshimet metabolike. E, kjo tregon sa të pambrojtur jemi ne, të gjithë, përballë sfidave të shekullit në të cilin jetojmë, shekull i cili ka më shumë tym e gaz sesa shëndet dhe ekologji...**

**Mos u dëshpëro, por mendoji të gjitha këto që i thamë më lart dhe mendo bardh e jo zi! Sepse, te njeriu është një motor, që e shtynë tërë makinën - e ajo është shpresa!**

**Ajo nuk duket, por e bën shpirtin të besojë të mirën dhe kalimin e krizës. Sidoqoftë, në jetë ndodhin shumë gabime. Ndodhin edhe te njerëzit më elitarë. Nga gabimet e mjekëve dhe trajtimet e gabuara, bie fjalla, në botë vdesin afërsisht 10 mijë njerëz në ditë.**

**Pra, mendo pozitivisht dhe gjërat do të vijnë në vend të vet...**



## Pse kënaqemi kur vjedhim?

Ka ardhur një modë e re te brezi i ri. Lajme tronditëse lexojmë çdo ditë në gazeta e në portale: "Djali rrahu nënën!", "Djali rrahu babën dhe e bëri për spital!", "Nënë e vajzë rrahin nusen!", "Nuse e burrë e rrahën nënën!" etj.

Pra, çka s'po ndodhë te ne! Andaj, edhe nuk është habi pse tokën e Kosovës e quajnë tokë të nëmur, siç quhen edhe Bjeshkët e Nemuna.

Po, kush na paskësh nëmur, ej? Vetëm ne të nëmur, kurse të tjerët bëjnë jetë të lumtur!

Ndoshta jemi të nëmur, sepse nuk punojmë për shtetin, nuk punojmë për progresin, siç punojnë të tjerët për shtetin e tyre... Ne nuk mundohemi të kemi një shtet të fuqishëm, sepse ëndërrimë të vjedhim sa më shumë...

ANKETË...

# A jetohet gjithmonë me një grua?

*Çdo lidhje dashurie i ka edhe problemet e veta, e disa janë edhe të patejkalueshme dhe jeta në çift plasaritet. Të anketuarve ua bëmë pyetjen: A jetohet gjithmonë me një grua apo vetëm me një burrë?*

## RILINDJA, PROFESORESHË: ZEMRA NJË HERË FALET!

- Jeta nuk është e gjatë dhe të mbajmë zi për atë që e kishim dikur në krahë e nuk e kemi më...

Nëse ia falë, ai përsëri do ma bëj edhe më zi, sepse ke të bësh me të njëjtin njeri. Andaj, nuk do të pranoja të rikthehem, sepse zemra një herë falet, e nuk do ia vlente të rifilloja me të njëjtin përsëri. Mbetët e kaluar ajo çfarë përjetuam bashkë, tani është i lirë dhe le të kërkojë dashuri të re, tjetër, se për mua ai do të jetë i vdekur...

## FILONA, EDUKATORE: NUK DO E LEJOJ TË LUAJ ME NDJENJAT E MIA!

- Meshkujt janë të atillë që vetëm pas humbjes së personit të dashur e kuptojnë vlerën e tyre.

Dhe, do ishte absurde ta prananim një gjë tillë, ngase, si sot e si nesër, përsëri do të bënte të njëjtat gabime.

Nëse njëherë e kam lejuar të luaj me ndjenjat e mia, nuk do të nguronte ta bënte prapë të njëjtën gjë, sepse, po të kishte respekt dhe dashuri në atë lidhje, nuk do të ishim ndarë dhe është e papranueshme nga ana ime.

## VERIMJA, DIZEJNATORE: DOJA T'I KTHEHESHA, POR NUK PRANOI

- Sa shumë doja ta pranonte ofertën time edhe një herë ish - i dashuri im pas ndarjes sonë, por ishte e kotë, ngase nuk donte as të fliste me mua, e lëre më të jemi bashkë! Jeta e tij kishte marrë kah tjetër, me një person tjetër dhe më unë nuk bëja pjesë në zemrën e tij...

Dhe, e tëra ndodhi me fajin tim.

Një gjë e kam të qartë: kurrë asnjëherë nuk do ta dua dikë siç e desha atë, por tani është vonë dhe çdo fjalë që e flas është e tepërt, e kotë.

## ARIANITI, KAMERIER: A JETOHET GJITHMONË ME NJË GRUA?

- Vajzat e mbajnë krenarinë shumë dhe i shtypin ndjenjat. Ato nuk flasin gjithmonë çfarë u thotë zemra.

Çdokush gabon, andaj, edhe ne, si të rinj, gabojmë dhe duhet të kemi edhe rastin për t'i përmirësuar gabimet.

Sikur të isha në vendin e saj, unë do ia falja gabimin dhe do e pranoja të jetë me mua, ngase prej një gabimi mëson.

Nuk është mirë të nisemi nga ajo që ka njerëz të përkryer dhe nuk ka vend për gabime, kjo është gjë e pamundur, ngase

një ditë e kupton se edhe për të është e rëndë të jetojë me dikë që nuk ta do zemra.

## FIONA, FARMACISTE: ZEMRA E LËNDUAR NUK SHËROHET!

- Ndarja vjen vetvetiu...

Dhe, nëse njëherë ndodh ndarja dhe prapë mendon të kesh një lidhje të shëndoshë po me atë person, vetëm gabohesh, meqë nëse njëherë të lëndohet zemra është shumë vështirë të shërohet.

Andaj, rikthimi i të njëjtit person në jetën tënde nuk ia vlen, ngase ai është i njëjti dhe nuk e meriton të merresh më me të.

## PËR FUND

Dashuria i mund të gjitha, madje edhe vuajtjet që i shkakton ajo. Secili nga ne mund të gabojë, ndoshta, edhe pa dashje dhe nga një gabim nuk është e mirë të vuani gjithë jetën, ngase një ditë mund të pendoheni, por, pa dyshim, do të jetë vonë...

Andaj, lëreni inatin anash, sepse dashuria është gjëja më e shtrenjtë në jetë.

A nuk do ia vlente një kërkim-falje për një dashuri të madhe dhe t'i harroni të gjitha, të jetoni të lumtur si dikur?

**Drita Haxhaj**



allure.  
BEAUTY

# Morpheus Fytyre


~~450€~~  
**300€**



Dhuratë:

1 Mezoterapi Lifting

1 Resting Peel





# Kush është babai i mushkave?

*Nuk guxoj të shkruaj çka mendoja me vete për këso rastesh, por dua të shprehem me anë të një shembulli...*

Kish dal Nastradini në tregun ku shiteshin kuajt, gomarët e mushkat. Të gjithë e kishin çmimin nga 100 akçe, pos njërit 50. “Pse ky është më i lirë?”, e pyet Nastradini shitësin.

“Sepse është babai i mushkave dhe është më budallai nga të gjithë!”, ia ktheu shitësi. Po në atë kohë dëgjon mbreti se në pazar shitej babai i mushkave. E thërret Nastradinin që të mësojë më shumë për këtë rast.

Nastradini i tha se babai i mushkave, edhe pse më plaku, mund të mësojë të lexojë,

madje edhe të shkruajë! Mbreti kur e dëgjoi se çka tha Nastradini, e pyeti:

“Nastradin, për sa kohë e mëson ti atë mushk të lexojë?”

“Për nja pesë a gjashtë vjet...”

Por, që ta mësoj mushkun plak të lexojë e të shkruajë më duhen para”, ia ktheu mbretit.

“Nastradin, të jap para sa të duash, por nëse nuk e mëson mushkun të lexojë ta heq kokën!”, ia ktheu mbreti.

Nastradini i kërkoi mbretit 100 mijë akçe, që ta mësonte mushkun të lexonte brenda pesë vjetësh dhe mbreti ia dha paratë.

Nastradini mori mushkun dhe paratë dhe u kthye në shtëpi. Gruaja u befusua kur i pa gjithë ato para dhe iu drejtua Nastradinin:

“Ku i more gjithë këto para?!”

“M’i dha mbreti, me kusht që këtë mushk, që e solla në shtëpi, ta mësoj të lexoj brenda pesë a gjashtë vjetësh”, ia ktheu ai.

“Po ku mësohet mushku të lexojë, o njeri?!” ia ktheu ajo.

“Brenda këtyre viteve ose cofë mushku ose vdes mbreti...”, ia ktheu Nastradini.

**D. F., Podujevë**



**MARINA BAY RESORT & CASINO**

# **FAMILY SEPTEMBER**

**ENJOY EXCLUSIVE PRICES**





# Belegu i Deçanit në sytë e mërgimtarëve

*Të dielën e fundit të gushtit të sivjetmë, nën një klimë të përzier ambienti malor, bjeshkët e Belegut të Deçanit e bëjnë krenar jo vetëm Deçanin, por edhe Kosovën...*

Njerëz të shumtë, kryesisht mërgimtarë, në të gjitha anët qarkullojnë në rrugët e ngushta me shumë kthesa, që çojnë nëpër vila të ndryshme, ku kalohet, zakonisht, vikendi.

E, kjo ka marrë dhenë sidomos viteve të fundit, kur malet e Belegut po bëjnë nam në turizmin vendor.

## **Ç'THOTË NIMONI, 72 VJEÇ, NGA NORVEGJIA?**

Nimoni, 72 vjeç, që kishte ardhur për vikend nga Deçani, e që jeton në Norvegji,

në bisedën tonë, thotë:

“Është mëkat të mos vizitohet kjo bukuri që e ka krijuar Zoti! Për kuriozitet, ky vend ndodhet në trekëndëshin Kosovë-Mali i Zi-Shqipëri”, thotë ai.

Ndërkaq, banorët e fshatit Beleg thonë se shteti duhet të ndikojë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, që ende është e pamjaftueshme për vizitorët e shumtë.

“Duhet të ketë investime të shtetit këtu, sepse në dy –tre vjetet e fundit ka shumë turistë të jashtëm që qëndrojnë këtu edhe me ditë të tëra.

Investimet e shtetit, por edhe të komunës,

do sillnin shumë leverdi ekonomike, sepse do rritej buxheti dhe ato para do e forcojnë vendin tonë.

Sidoqoftë, përfitimi nuk është vetëm ekonomik, por do shtohet edhe imazhi që të kemi sa më shumë vizitorë, qoftë vendorë, por edhe të jashtëm.

Prandaj, është me shumë interes zgjerimi i rrugëve dhe rregullimi i tyre, në mënyrë që të ketë ndërtime vilash dhe motelesh, thotë në vazhdim të bisedës sonë Vigan, nga Peja, e që aktualisht jeton në Francë, një nga vizitorët që hasëm në këtë vend pitoresk.

## **BJESHKËT E BELEGUT ME SHTEG PËR KËMBËSORË**

Bjeshkët e Belegut, me disa kilometra shteg për këmbësorë, ende janë larg nevojës reale për ta ndryshuar gjendjen ekzistuese...

Janë bërë edhe disa pika turistike në të cilat mund të vendosen vizitorët për qëndrime ditore.

E, ajo që e veçon këtë trevë është fakti se kudo gjejmë ushqime tradicionale, e që shfrytëzohen me të madhe nga vizitorët.

Në anën tjetër, për ata që duan natyrë origjinale, ujë ka me bollëk dhe të pastër si loti.

## **BUKURITË E BEKUARA...**

Vizitorët e pasionuar me natyrën dhe ecjen në bjeshkë, thonë se në Beleg e gjejnë, si askund tjetër, një botë të veçantë malore, të ruajtur me egërsinë e vet të paprekur nga dorë njeriu.

Me natyrë të pastër, që rrallë kund e gjen, bjeshkët e Belegut paraqesin shembullin më tipik për çaste të paharruara.

Në këtë vis kosovar vijnë vizitorë nga të gjitha anët e Kosovës, sidomos mërgimtarët. Ata këtu gjejnë ajrin e pastër dhe të shëndetshëm për frymëmarrje.

Dhe, në një lartësi mbidetare mbi 2000 metra, bjeshkët e Belegut do të bëhen herë do kur urë lidhëse me Plavën dhe rajonin, duke nxitur edhe turizëm rajonal dhe qarkullim trafiku të shtuar.

Andaj, me të drejtë bjeshkët e Belegut të Deçanit quhen "bukuritë e bekuara".

Në këtë natyrë të bukur, në Beleg, njohësit e bimëve shëruese i vjelin ato gjatë pranverës e verës (mbi 43 bimë shëruese), të cilat janë të njohura me shekuj në këto

anë.

Bimët: kantariumi, çaj mali, lëngu i trupit të drurit nga breza përdoren për shërim...

## **SI T'I RUAJMË BUKURITË NATYRORE?**

Për t'i ruajtur bjeshkët e Belegut, thonë bashkëbiseduesit, duhet investuar në ngritjen e vetëdijes dhe të shtohet kujdesi institucional në raport me shtimin e kujdestarisë ndaj zjarreve verore, që po ndodhin shpesh, e që mund të bëjnë kërdi ekonomike.

"Njerëzit duhet t'i ruajnë bukuritë natyrore që na i ka falur Zoti, e jo të jenë shkatërrues të tyre!", thotë Dema, 66 vjeç, nga Skivjani i Gjakovës, i cili jeton në Gjermani, e që pushimin veror kryesisht e kalon në bjeshkët e Belegut.

Dhe, vonë pasdite, pas një dite të relaksuar në bjeshkët e Belegut, marrim rrugën për në Prishtinë, me mushkëritë e mbushura ajër të pastër të kësaj treve, që ka ditur vetëm Zoti i madhërishtëm ta krijojë...

Andaj, me të drejtë vendasit bjeshkët e Belegut i quajnë "Bjeshkët e bekuara"!

**B.Bajrami**



# Inxhe, sa e ke "çmimin"?



*Në kohën e sotme më nuk ka lezet asgjë. Secili është bërë më egoist se tjetri. Ndërsa, ata që kanë biznese mendojnë se mund të të blejnë edhe ty, si maunat me mall nga Serbia!*

Ulem në një kafiteri për të pirë kafe dhe pas pak dëgjoj fjalët: "Bani sevap!?"

Nuk kalon shumë kohë dhe, përsëri, vjen tjetra për lëmoshë...

Dhe, edhe pse nuk dua të flas me asnjëri e dua të jem e qetë, përsëri njeriu është i shtrënguar të flasë dhe për një minutë duhet t'u japë përgjigje lypsarëve, të cilët janë të shtrënguar të fitojnë bukën e përditshme...

E, ajo fitohet kush si mundet...

Por, kjo të prish imazhin e qetësisë dhe për një çast të bëjnë nervoz dhe detyroresh, ndonjëherë, edhe t'ua kthesh me ton të lart, madje edhe t'i fyesh, apo t'i lusësh të të lënë të qetë...

Por, shpeshherë, kur mendon se si do të ndihen ata, kjo të shqetëson shumë...

Dhe, pa dyshim, bëhesh egoist sa që nuk mund ta njohësh as vetveten. E, kjo, pa dyshim, na ndodhë çdo ditë...

Edhe kur i japim në rrugë lëmoshë ndonjë plake a plaku, këtë e bëjmë për egon tonë...

Edhe në shkollë, në punë, e kudo tjetër, vazhdon e njëjta reprizë...

Por, ajo që më la mbresë të pashlyeshme, është ndodhia teksa shëtisja me time shoqe një të diel të gushtit në sheshin e Prishtinës.

"Lum burri që të paska, oj inxhe! Sa e ke "çmimin?", i tha një i ri shoqes sime, nga katër shokët që ishin bashkë, teksa kaluan pranë nesh.

Ndërkaq, ime shoqe, duke mos i përfillur fjalët e tij, vetëm buzëqeshi dhe vazhduam rrugën.

Por, as sot nuk po më hiqen nga mendja fjalitë: "Lum burri që të paska, oj inxhe! Sa e ke "çmimin?"

**Drita Haxhaj**

Radio,  
Lajme, Moti,  
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin  
**SHKABAJ** për Android

ANDROID APP ON  
Google play

**Shkabaj**  
Fillo këtu.  
www.shkabaj.net



# A do me mbet çift pa u nda?!

*Nuk ka pasur kurrë më shumë ndarje të çifteve bashkëshortore në Kosovë se sa që ka sot! Kjo që sot po ndodh në Kosovë është një turp që nuk justifikohet me fjalë...*

Mund të tingëllojë utopike e vërteta se në fshat kanë qarë i madh e i vogël kur është ndarë një çift...

"Pse, si erdhi te ndarja?", ka pyetur i madh e i vogël, edhe nëse nuk e ka lidhur asgjë me çiftin familjarisht. Sepse, ka pasur vlerë jeta, ka pasur solidaritet. Ka pasur fytyrë e burrëri...

Burrat dikur thoshin: "Gruaja dihet për çka lëshohet. Dhe, kur lëshohet - kërcet pushka!".

Kur ka ndodhur një ndarje është marrë burrëria me të dhe e kanë shtruar problemin në odë, duke pleqëruar burrat.

E, sot?!

Fill pasi fejohen e merr me vete i fejuari të fejuarën në shtëpi dhe e mbanë me muaj të tërë, kurse pas një zënke të vogël ndahen, kinse nuk qenkan për njëri-tjetrin!

Dhe, askush nuk merret me ta!

Pra, e mbanë të fejuarën sa të dojë dhe e lë kur ia do qejfi!

Keq, a?

A ka këtu burrëri?

Pa dyshim, jo. Sepse, po të kishte burrëri si dikur, nuk do të ndodhnin gjëra të tilla...

Dikur kanë pyetur nga i ka dajallarët djali a vajza...

E, kush pyet sot nga i ka dajallarët vajza a djali?! Nuk pyet askush, sepse është krijuar vetëdija se mjafton të duhen ata dhe të shpallen burrë e grua...

## BURRËRI KISHTE PAS SELMAN KADRIA...

Burrëri kishte pas lënë Selman Kadria, që e ka përmendoren në hyrje të fshatit Cërcë të Istogut, kur e kishte vrrarë Miliç Kërstën, i cili i maltretonte banorët shqiptarë në fshat dhe në fshatrat përreth.

Ai kishte shtënë me manzere në Miliçin, duke e lënë të vdekur në vend dhe duke pësuar edhe vetë nga daja i tij, që kishte pasur marrëveshje me çetnikët në Istog! E, sot devijimi i burrërisë nis që nga faza e shkollimit, sepse fëmijët dinë të shajnë dhe të ofendojnë me të gjitha format ofenduese. E, sharja nuk i bën përshtypje palës tjetër që i drejtohet! Shtrohet pyetja: Pse sot nuk qon peshë sharja?!

Sepse, nuk i qon shumë peshë as nëna e as motra atij që i shahet dhe se ka degraduar jeta familjare aq shumë sa shajë kë të duash dhe si të duash...

**Burim Bajrami**



# Nga Prizreni me biçikletë për në Indonezi që ta takojë të dashurën!

*Thonë se dashuria nuk njih kufij. Me sa duket, këtë thënie do e dëshmojë në praktikë djaloshi Ceki Hoti, i cili është nisur nga Prizreni gjatë muajit gusht me biçikletë që të shkojë në Indonezi, sepse atje e ka gjetur dashurinë e jetës në rrjetet online.*

Djaloshi nga Prizreni, Ceki Hoti, gjatë muajit gusht është nisur për në Indonezi me biçikletë që ta takojë vajzën që e njohu online dhe shpreson ta takoj pas një viti udhëtim. Pra, një sfidë jo e lehtë...

Ky rrugëtim, sipas tij, do të jetë 13 mijë kilometra dhe parashihet të zgjasë një vit, ku 80 për qind të kohës do e kalojë në tendë e 20 për qind në hotele.

"Epo, siç thonë, njeriu shkon në fund të botës për dashuri, prandaj unë do e bëj të njëjtën.

E gjeta dashurinë time dhe në Indonezi do ta takoj!

Me bekimet e Zotit dhe me përkrahjen tuaj të dashur, shpresoj se do t'ia dal", thotë Hoti dhe vazhdon: "Edhe për nga ana fizike jam i gatshëm, por edhe për nga ana psikike, po ashtu, jam i gatshëm.

Do të jetë sfidë shumë e madhe, por shpresoj se do ia dalë".

Aktualisht ka arritur në Turqi dhe prej atje do të kalojë në Iran që të vazhdojë rrugën për në Indonezi.

"Dashuria është tempulli që jam duke e ndërtuar, ndërsa biçikleta është motori. E, dashura ime ka pranuar", thotë ai nga Turqia.



 **anaderm**

Klinika Dermatologjike  
dhe Estetike

**ZBRITJE**

**30%**

**Mbushja e fytyres me  
dhjamin e trupit**

Rigjenerimi i lëkurës me Seffiline

**Oferta vlen deri me 30 Shtator**

Rezervo | +383 (0) 44 300 298





*Pse lexoj? Ndoshta se dituria na fuqizon, lexoj për të gjetur shpresë kur sensi i jetës shpirtërore nuk është gjithmonë në harmoni me jetën ku nuk je ti gjithmonë regjisori, por vetëm aktori. Lexoj për të mësuar përrulësinë për të mos humbur dashurinë, për t'i ndihmuar vetes kur ndihem e thyer, kur ndjej frikë dhe, para së gjithash, për të gjetur qetësinë, qetësinë që ta përkujton lirinë!*

# Të gjithë kemi një kapitull në jetën tonë që nuk duam ta lexojë askush!

I dua librat, edhe pse shumë shpesh si fëmijë dëgjoja qortimet që tingëllonin "Lëri më ato libra, se librat nuk të japin me hangër dhe qohu puno diçka!". Meqë isha vajza më e madhe në familje, "humbisja" shumë kohë me libra, duke harruar se punët e katundit e kishin orarin e tyre!

Pa dashur të humbi kohë shumë në libra, prapë ishte dëshira ime e vetme për të gjetur diçka të mençur që do ndizte një shkëndijë në mua.

Si për ironinë e jetës time, më kujtohet thënia: "Ke sunduar mendjen, ke sunduar botën!", që kuptimin e saj në atë kohë si adoleshente e kisha perceptuar krejt mbrapsht.

Vetë fjala sundim kishte krijuar në imagjinatën time bindjen se që të arrij diçka në jetë, siç duket, duhet të bëhem një femër e fortë dhe e pamposhtur që të "sundoj" jetën dhe veten, duke ngatërruar pa vetëdijë mendjen me egon, e për shpirt nuk bëhej fjalë!

## TË REFLEKTOJMË MBRAPA!

Thuhet se jeta jetohej vetëm përpara, por kuptimi rezultoi veç kur reflekton mbrapa! Kështu, entuziazmi për të "sunduar" veten rritej bashkë me egon, duke korrë rezultate dhe suksese dhe bashkë me të rriteshin edhe pritshmëritë, përpjekjet për përsosmëri, që, në realitet, kisha harruar faktin se dikur kisha mësuar gjatë studimeve në psikologji se njerëzit që performojnë shkëlqyeshëm janë të përsosur, kryesisht motivohen nga frika, nga frika se nuk mjaftojnë ashtu siç janë dhe ndër ata njerëz isha edhe unë!

Ose, si shumica e femrave shqiptare, ku nga fëmijëria na ngulitet në mendje një lloj përsosmërie për t'u bërë, pastaj, të varura nga këmbimi i arritjeve me kompensim të dashurisë dhe për të fituar epitetin "të qenit çikë e mirë".

Pastaj, përpos togfjalëshit "të qenit çikë e mirë", vazhdon me epitete të tjera, si: "nuse e mirë", "bashkëshorte e mirë", "nënë e mirë"... Në shoqërinë tonë është (ose ishte) një listë me kushte dhe vlera të pa imagjinuara për një personalitet të vetëm, ku leximi mendoj se ishte, ndoshta, në listë kah fundi!

Kështu, duke ndjekur ideat e femrës "perfekte", unë, përpos leximit për shkollim, u largova nga pasioni, sepse ende ishte i ngulitur besimi se nuk duhet humbur kohë duke lexuar libra kot, se vetëm puna është ajo që të qon përpara.

Mirëpo, ndodhi e kundërta, sepse puna më bëri të jem mirë materialisht, por u varfërova shpirtërisht dhe gati arrita në Burn-out fizikisht! Dhe ku gjeta prehje dhe qetësi shpirtërore pos në lexim dhe vetëm në lexim. Vetëm aty qetësohej mendja ime, vetëm aty frika dhe stresi humbiste rëndësinë. Vetëm në lexim ulej niveli i kortizolit dhe vetëm në lexim prapë kuptova se unë nuk duhet, medemos, të jem perfekte që t'më duan, se është egoja ime që më mashtron se unë duhet të jem e gatuar me recept. Vetëm me lexim kuptova se krejt çka më nevojitet është jo të sundoj, por ta dua dhe ta pranoj me dashuri dhe mëshirë veten me të gjitha karakteristikat e mia që kam, e që aspak nuk janë perfekte!

## KURRË NUK ËSHTË VONË PËR LEXIM!

Dhe, si çdo gjë tjetër në jetë, siç duket, të disa njerëz edhe libri ka kohën dhe rolin e vet dhe se asnjëherë nuk është vonë për të vazhduar apo rifilluar leximin dhe studimin. Kur ne nuk mohojmë madhështinë tonë dhe fillojmë ta duam veten, ne bëhemi më të qetë dhe më të dashur për veten dhe për të gjithë ata që na rrethojnë.

Mirëpo, edhe një ta kemi parasysht: të lexuarit, ndoshta, na bën më të informuar, por jo më të mirë se tjetri.

Dituria nuk ka kufij. Siç ka thënë Sokrati: "E di një gjë që nuk di asgjë".

Po e përfundoj me këtë citat dhe me një këshillë se jo dituria, por vetëm dashuria na ndihmon të kalojmë prej mençurie në urtësi pa mendjemadhësi!

**Shkëndije Pacolli**



**PRAXIS FÜR  
PSYCHOLOGISCHE  
BERATUNG**  
Shkëndije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de  
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6  
56422 Wirges

# BOOM



Shqiptari  
Albert Gjokaj  
krijon këpucë  
e çanta luksoze  
nga lëkura  
e krokodilit

# Shqiptari Albert Gjokaj krijon këpucë e çanta luksoze nga lëkura e krokodilit

*Mr. Dapper është brendi i këpucëve luksoze, i cili në trojet shqiptare u bë i njohur përmes një emri, Albert Gjokajt, njeriut që ia del suksesshëm të krijojë këpucë unike, luksoze dhe të jashtëzakonshme në dizajnin dhe cilësi.*

*Mr. Dapper është një biznes aksionar me butikun në Luzern dhe butikun online.*

*Siç kuptojmë, merret me shitjen, riparimin dhe dizajnimin e këpucëve me porosi për klient individual. Por, po ashtu, butiku vizitohet edhe nga njerëz nga gjithë bota.*

*Në asortiment ka edhe çanta, jakne dhe aksesore nga lëkura të ndryshme të cilësisë së lartë për xhentëlmën.*



#### **Cili është specialiteti juaj?**

- Ne jemi të specializuar në këpucë dhe çanta me lëkurë krokodili dhe aligatori. Mund ta bëjmë çdo çantë dhe këpucë sipas kërkesave të klientit. Shpesh prodhojmë çanta që duken të ngjashme me Hermes Birkin në të gjitha ngjyrat e mundshme.

#### **Lëkura e sa krokodilëve duhet për një çantë të tillë?**

- Për një çantë të vogël për meshkuj, me gjërësi 24 cm, na duhen 2 krokodilë. E, për një çantë grash 35 cm na duhen 4 lëkurë krokodili, sepse ne marrim vetëm

pjesën më të mirë të lëkurës, pra vetëm barkun.

Dhe, të gjitha lëkurat tona të krokodilit dhe aligatorit janë nga ferma të kualifikuara dhe dorëzohen me një certifikatë nga ferma, të cilat i nënshtrohen një kontrolli të madh nga autoritetet e mirëqenies së kafshëve kur mbërrijnë në Zvicër.

#### **Çmimi më i shtrenjtë i çantës që e keni punuar dhe shitur?**

- Ka shumë cilësi të ndryshme të krokodilëve dhe aligatoreve. Ne marrim vetëm aligatonin Missisipi nga SHBA ose krokodilin Porosus nga Australia.

Këto janë speciet më të shtrenjta dhe lëkurat vijnë nga ferma të kualifikuara, prandaj kushtojnë më shumë.

Një çantë fillon nga 8.000 €, në varësi të madhësisë dhe mund të kushtojë deri në 25.000 €.

### **Kush ka qenë blerësi i këpucëve ose çantës më të shtrenjtë?**

- Fatkeqësisht, nuk më lejohet të jap asnjë informacion për blerësit, por kur bëhet fjalë për meshkujt, janë kryesisht shqiptarët ata që vlerësojnë cilësinë dhe dizajnin. Në mesin e zonjave ka femra krejtësisht të ndryshme, ka të reja apo edhe më të moshuara, që i duan çantat në ngjyrën e dëshiruar.

### **Kushtojnë më shumë këpucët apo çantat?**

- Çantat kushtojnë më shumë, sepse kërkojnë më shumë lëkurë. Për këpucët na duhen gjithmonë 2 lëkura krokodili. Por, mund të bëjmë edhe xhaketa krokodili, e që i bëjmë te një rrobaqepës partner në Romë.

### **Këpucët më të shtrenjta?**

- Këpucët tona më të shtrenjta deri më sot ishin 18.000 euro, blerë nga një shqiptar.

### **Krijoni dhe shisni veç produkte qaq të shtrenjta, apo ka variacione edhe në çmime?**

- Në dyqanin tim kam jo vetëm produkte qaq të shtrenjta, por edhe produkte që i kemi në magazinë të cilësisë më të lartë, të bëra prej lëkurës së viçit, duke filluar me këpucët rastësore nga 290 € dhe këpucë klasike nga 450 €.

### **Kush janë personat që i blejnë çantat dhe këpucët tuaja?**

- Në Zvicër kemi shumë kombësi, kështu që kemi klientë nga të gjitha vendet.

Por, të jem i sinqertë, unë preferoj klientët shqiptarë dhe amerikanë, sepse dinë çfarë duan ose shpesh më besojnë dhe

më lënë ta dizajnoj dhe ta bëj vetë.

### **Blejnë më shumë meshkujt apo femrat shqiptare?**

- Kur bëhet fjalë për meshkujt, kryesorët janë shqiptarët e suksesshëm që kanë blerë çanta dhe këpucë.

Më vjen mirë që njerëzit tanë janë bërë qaq të suksesshëm. Ata u munduan shumë dhe punuan për sukses, duke ia dalë të kenë në gardërobën e tyre dhe gjëra luksoze e me vlerë.

### **Ju ekspozoni edhe në vende të ndryshme?**

- Unë, gjithashtu, mbaj shpesh ekspozita në Miami, ku prezantoj produktet e mia dhe fitoj klientë të rinj. Së shpejti do të kem një ekspozitë me Rolls Royce në Palm Beach.

### **Suksesi yt më i madh deri tani?**

- Suksesi im më i madh është arritja e dytë në Kampionatin Botëror të Këpucëve 2024 në Londër.

Por, më së shumti u lumturova kur u nominova për Swissalbs.

Pas shfaqjes Swissalbs kam pasur shumë reagime nga njerëzit tanë dhe kjo më gëzon. Lumturohem kur njerëzit e mi më mbështesin.

### **Jeni shqiptar krenar, vërtet!**

- Ne, shqiptarët, ishim të shtypur për një kohë të gjatë, madje edhe jashtë vendit shumë prej nesh kishin përdorur emra italianë për biznes.

Por, ne jemi vetëm në pikën ku mund të paraqesim me krenari emrin dhe origjinën tonë në modë, orë, restorante dhe shumë industri. Jam më i lumtur kur kam një klient shqiptar sesa 10 të tjerë të nacionaliteteve tjera.

Mr. Dapper  
6003 Luzern  
email:  
albert@mrdapper.shoes  
Instagram:  
mrdapper.shoes



# Shqiptarët raca më e bukur në Evropë

*Për ne, shqiptarët, se jemi racë e bukur kanë shkruar edhe njerëzit dhe mediet më të njohura botërore. Gazeta e përditshme prestigjioze "New York Times" ka pasur një artikull se "shqiptarët janë raca më e bukur në Evropë". Ky është konkluzioni i një shkrimi të publikuar më parë, i cili sillet tashmë sërish në vëmendje...*

"Fizikisht shqiptarët janë raca më e bukur në Evropë. Gratë shqiptare janë shumë të bukura, me flokë të errëta dhe nganjëherë sytë e tyre janë gri.

Ecja e tyre është një kënaqësi për t'u parë, e kështu janë edhe vallet e tyre. Herën e parë që pashë vallen shqiptare, më dhanë një kënaqësi të veçantë", shkruhej në artikullin e gazetës "New York Times".

Artikulli vlerëson edhe kërcimet tradicionale shqiptare, por nuk lë pas as bukurinë fizike dhe inteligjencën e meshkujve shqiptarë.

"Lëvizjet janë elegancë dhe tregojnë forcë. Po ashtu, ato janë shumë të bukura dhe shumë të koordinuara".


E, se shqiptarët janë racë e bukur tregon më së miri edhe bukuria e princeshës së dikurshme egjiptiane me prejardhje shqiptare, Favzija Fuad, e cila u bë grua e mbretit të Iranit, Rizah Pahllavit. Po kështu, nëse analizohet bukuria e aktorëve shqiptarë Blerim Destani e Nik Xhelilaj, e misit Agnesa Vuthaj, e këngëtares me famë botërore Dua Lipa etj., vetëm sa e forcojnë konstatimin e lartpërmendur.



Princesha Favzija



Blerim Destani



Dua Lipa



Nik Xhelilaj



Agnesa Vuthaj





Barbara Mori

## Sa dashnorë i ka pasur "Rubi"?

*Kush nuk e mban mend Rubin, aktoren e famshme Barbara Mori, e cila u përçoll një kohë të gjatë në televizionet tona? E lindur më 2 shkurt 1978, në Amerikën Latine, konkretisht në Uruguaj, është një nga aktoret shumë në zë si nga talenti ashtu edhe me pamjen e saj të përsosur.*

Ajo edhe vetë e pranon se e kaluara e saj nuk ka qenë e lehtë. Me kalimin e viteve, marrëdhënia e saj me burrat ishte e ndërlikuar, situata nga të cilat ajo tani vlerëson mësimet të mëdha të jetës që e kanë lejuar të rritet dhe të përmirësohet si person.

Barbara thotë, megjithatë, se ish-partnerët e saj nuk e kanë abuzuar kurrë fizikisht. Abuzimi ka ndodhur në një mënyrë tjetër, sepse në atë kohë ajo kurrë nuk besonte se meritonte diçka më të mirë.

Pjesërisht këtë mendim aktorja ia

atribuon edukimit që ka marrë nga babai i saj, i cili e ka dhunuar fizikisht kur ajo ishte e vogël.

"Më gënjyen, më tradhtuan dhe marrëdhënia ime me burrat ishte shumë abuzive ndaj meje. Babai më ka dhunuar fizikisht, më ka lënduar shumë, ka qenë shumë i dhunshëm, por kurrë nuk kam pasur një marrëdhënie ku jam goditur, kam pasur një marrëdhënie ku jam keqtrajtuar absolutisht në të gjitha fushat e tjera dhe nuk e njihja abuzimin. Mendova se e meritoja të trajtohesha kështu,

sepse nuk isha e denjë dhe nuk isha e vetëdijshme për këtë, e zbulova kur fillova të punoja me veten dhe thashë: "Hej, çfarë po ndodh me këtë?". Megjithatë, në atë kohë mendoja se nuk meritoja ndonjë gjë më të mirë", thotë aktorja.

Pas këtyre ngjarjeve të dhimbshme, Barbara gjeti kohë për të punuar me veten, duke mbyllur përfundimisht një cikël abuzimi nga ish-partnerët e saj.

Ajo tani jeton e lumtur me partnerin e saj, producentin Fernando Rovzar.

# Kallushan mustaqezi...

*Për të dëshmuar burrëri nuk mjafton vetëm të jesh trim dhe të vrasësh. Nuk mjafton të të frikësohen të tjerët në mënyrë jomeritore. Nuk mjaftojnë as vetëm mustaqet deri te veshët, as shqiponja në ballë në plis, siç është mbushur sheshi i Prishtinës me ta! Për të qenë burrë më shumë duhet të falësh dhe të tolerosh, lypset sakrificë dhe mund. Sepse, burrë të madh e të mirë të bën vepra...*



Linkolin, për të cilin do flas në këtë shkrim, nuk ishte ish-presidenti amerikan. Ai ishte një zezak skllav, që e shfrytëzonin mizorisht klasa e bardhë borgjeze në Amerikë, më 1865. E morën dhe e shitën bashkë me gruan dhe vajzën e tij, por tregu i shitjes e kishte ndarë familjen në dysh. Linkolin ishte shitur nga pronari për ta larë një borxh të majmë, meqë zezaku skllav kishte zotësi dhe inteligjencë të lartë, edhe pse nuk kishte shkollë.

Klasa borgjeze, e që përbëhej nga raca e bardhë, nuk i lente të shkonin në shkollë, sepse ata mund ta lexonin Biblën dhe aty të demistifikonin kamuflimin borgjez se zezakët i kishte lindur Zoti për të qenë robër të të bardhëve dhe se ata kishin ardhur në jetë për të bërë punë të rënda.

Linkolin, që e shitën te një pasanik, mori detyrën të ndërtonte një barakë dhe, teksa e shikonte pronari, i bëri vërejtje që dërrasat duhej të gozhdoheshin, duke mos u dalluar se ishin ngjitur njëra pranë tjetrës.

Kur Linkolin e bëri barakën me dërrasa, erdhi padroni dhe, duke qenë i etur për ta rrahur, i vuri lakun në fyt për ta varur dhe e la me litar në fyt një ditë e një natë, në majë të gishtërinjve të këmbëve, si dënim. Ditëve të tjera ai qante vazhdimisht...

Një ditë një i bardhë, shpirtmirë, e pyeti: "Pse qan çdo ditë?"

Linkolini i tha:

"Do isha njeriu më i lumturi në botë sikur ta shihja gruan dhe fëmijën edhe një herë, sepse kanë kaluar më shumë se 20 vjet pa i parë!"

Njeriu i bardhë u ndie keq.

Dhe, duke ndjerë shpirtin lotues të zezakut, u interesua të dinte për familjen e tij. Gruan ia kishin vrrarë, kurse vajzën e kishin martuar për një shërbëtor të zi, që ishte në grupin e

të besuarve të bardhë.

I bardhi, kur mësoi për gjendjen e familjes së Linkolnit, nisi ta kërkonte atë dhe e gjeti duke punuar në arë, me skllavër të tjerë. Kur e gjet, e nxori nga puna dhe e qoi në shtëpi, ku edhe ndodhej vajza e tij me djalin e sapolindur.

Por, para se ta qonte në shtëpi, Linkolin e kishte veshur me roba të mira, për ta prezantuar para vajzës së tij tashmë grua.

Kur hyri zezaku në sallonin e shtëpisë së bukur, në këmbë qëndronin tri zonja, padroni i bardhë dhe një fëmijë i mbështjellë me batanije. Zezaku bëri ca hapa dhe u ndal, duke hequr borsalinën nga koka. Vajza e tij, e që nuk e njohte, kishte pasur privilegjin të shërbente brenda shtëpive të pasanikëve dhe ajo klasë gëzonte më shumë respekt se skllavërit që jetonin në ara, kryesisht në fushat me pambuk.

Zezaku i shikonte shërbëtoret, me shpresë se njëra nga to do jetë gruaja, por asnjëra nuk ngjasonte në gruan e tij...

Dhe, kur pa se asnjëra nuk ishte gruaja e tij, nisën t'i dalin lotët nga sytë...

Në çast, iu ofrua vajza dhe i tha:

"Ky fëmijë, i mbështjellë me batanije, është nipi yt!"

Dhe, në ato çaste, Linkolini filloi të qajë edhe me zë...

Mirëpo, për fat të mirë, nuk zgjati shumë e ra aparteidi dhe erdhi liria për zezakët në Amerikë. Ndërkohë, Linkolini ngriti padri ndaj borgjezëve për vdekjen e dhunshme të gruas së tij dhe në po atë vit doli para gjyqit me të akuzuarit.

Padronët e bardhë u shpallën fajtorë për akt dhune ndaj gruas, por Linkolini hoqi dorë nga burgosja e tyre me nga 20 vjet burg. Ai i kërkoi gjyqit t'ua ndërronte vendbanimin racistëve gjakpirës, e që ia kishin zhdukur

familjen dhe vazhdoi jetën i qetë, duke mos dashur të dënohej askush për familjen e tij! Sidoqoftë, vazhdoi ta jetojë jetën me lot, por nuk pranoi të shkonin të bardhët në burg për vrasjen e gruas së tij...

E, kësaj i thonë burrëri se jo mahi!

## MUSTAQET E FRIKSHME...

Në popullin tonë mustaqet e gjatë dhe plisi janë konsideruar veprime të shenjta, që përfaqësojnë burrëri dhe dinjitet. Janë të paktë ata që i kanë mbajtur origjinal dhe janë të shumtë që kanë mbajtur dhe i mbajnë fals. Hyn një burrë te berberi në Prishtinë. Sheh në pasqyrë një burrë teksa berberi ia rregullonte mustaqet e gjatë. Ai kishte jelek me qostek dhe pasqyronte burrin e fortë.

Edhe burri që hyri te berberi dukej njëjtë.

Në çast, ai, duke menduar se mustaqet nuk hiqen për gazep të madh, i tha:

"Ti, bre burrë, a po i heqë mustaqet apo po i heq unë?!"

"Po i heq unë!", ia ktheu ai.

Burri, në çast, shau mustaqet, duke ia kujtuar atij se nuk ia kishte zënë rrugën mustaku i tij, por se gjeti, më në fund, një burrë që e pranon të vërtetën...

E sot, te ne, në sheshin e Prishtinës, sheh "burra" me mustakë të gjatë e mjekra që nuk u vlejnjë për asgjë! Sheh burra me plis, në ballë shqiponjën!

E, në fakt, janë burra falas, si ai që ka pranuar t'i heqë mustakët te berberi...

Sido që të jetë, mustaku në të kaluarën tregonte njëfarë burrërie. Në fakt, kemi kaluar një shekull në luftë me Serbinë dhe, qoftë me fe e me realitet, mjekra e mustaku janë mbajtur për ta tmerruar armikun...

E, pse mbahen sot?!

S. Murturi

AUTO  
ALBERTI



 /autosallonialberti

Kontakti: + 383 49 373 373  
Email: autosallonialberti@hotmail.com

# Sytë e saj rrush Rahoveci!

*Kur e kishte shikuar për herë të parë kah po i ndërronte hapat, kishte pasur përshtypjen se para tij po defilonte një manekine, e cila ecte në sfilatë mode.*

Ecja e saj karakteristike aq shumë ia kishte tërhequr vëmendjen dhe aq shumë i kishte lënë përshtypje, sa që, nga ai moment, kishte filluar ta humbë qetësinë e shpirtit, e të ëndërronte veten e tij, të shndërruar në një qilim të shtruar, mbi të cilin do të shkelte këmba e saj...

## KËMBËT E BUKURA...

Zeshkania me ecjen e saj karakteristike jo vetëm që e kishte joshur, por edhe e kishte çmendur me këmbët e saj të bukura. Ato ishin magnet që tërhiqnin jo vetëm shikimin, por edhe tërë qenien e tij dhe e shpërqendronin të tërin. Madje, ato

këmbë të bukura të saj ishin bërë pjesë e pandarë edhe e ëndrrave të tij, që i shfaqeshin posa fillonte të dremitej. Ëndrrat ishin të vetmet bashkëbiseduese me të, sepse vetëm me to guxonte të komunikonte, e vetëm atyre mund t'ua tregonte fshehtësinë.

Atyre e askujt tjetër ua shprehte ndjenjat që ushqente ndaj zeshkanes, e vetëm ato mund t'i flisnin për këmbët e bukura të saj. Madje, ato i dëftonin se kah e bartnin ato këmbë gjatë ditës, ku i shtrinte gjatë natës, madje edhe ku i freskonte e ku i depilonte ato...

Nuk i lejohej në asnjë mënyrë të fliste me asnjë njeri rreth takimeve aq të pakta që i kishte me zeshkanen. Madje, as emrin e saj nuk i lejohej ta përmendte në prani të tjerëve.

Dhe, meqë i dukej se po eksplodonte nga bukuria, e quante "bombastikë", sepse ajo, vërtet, ishte si lëndë shpërthyes, si granatë që kur shpërthen dridh tokën.

## BUZËT QERSHI...

Ndonëse granatonte me shkëndijat që dilnin nga shikimi i saj, ata sy të bukur i kishte si rrushi i Rahoveci.

Meqë kishte shikim të ëmbël, kjo edhe e kishte shtyrë të mendonte se puthjen e parë t'ia dhuronte syve të saj magjepsë.

Por, ndjenjat e kishin tradhtuar, sepse atë puthje ua kishte dhuruar buzëve të saj të ëmbla si qershi Dukagjini. Madje, puthjen e parë në buzët e ëmbla ia kishte dhuruar mu pranë bregut të Drinit, aty ku edhe ndodhen pamjet madhështore përreth lumit, që kishin çarë bregoren përmes për të krijuar legjendën e Urës së Shenjtë. Dhe, teksa dashuria ndaj zeshkanes sapo merrte hov e po zhvillohej, papritmas po shembej e shkatërrohej, sepse po përshkohej nga një rrymë e ftohtë që po e rrëronte. Kjo po i ndodhte, sepse në shumë raste, mu atëherë kur vullkani që po shpërthente e po nxirrte nga brendia llavën përvëluese të dashurisë, vinte një valë e ftohtë sikur të dilte nga thellësia e ftohtë e Drinit, për ta ftohur, për ta shuar, madje edhe për ta ngrirë atë zjarr vullkanik që kishte filluar.

## TAKIMI QË NUK NDODHI...



Ai e donte, e ëndërronte, e dashuronte, andaj kishte dëshirë edhe ta shijonte. Si ta realizonte një takim të tillë ku do t'ia shijonte të gjitha: buzët, sytë, flokët, shpatullat, gjoksin, këmbët dhe gjithë trupin e saj të bukur si margaritar?

P. K.



CIMA GRAND COMPLEX

PRISHTINA E RE

   [www.cimaks.com](http://www.cimaks.com)



CIMA GRAND COMPLEX

PRISHTINA E RE

   [www.cimaks.com](http://www.cimaks.com)

# 41 vjet i kalova

## me një gëzim në jetë!

*Gjatë korrikut që e lamë pas u takuam rastësisht në plazhin e Ulqinit, pas 41 vjetësh. E, mu kjo ishte arsyeja pse kisha jetuar 41 vjet për atë ditë...*

Gjatë korrikut të sivjetmë që e lamë pas, një zonjë e rëndë qëndronte në rërën e Plazhit të Madh të Ulqinit me libër në dorë. Dhe, dukej se ishte më e preokupuar me fëmijët që lahashin në det sesa me librin që e mbante në dorë.

Unë isha shtrirë në drejtim të ujit të detit dhe vështroja një pulëbardhë, e cila afrohej deri afër meje në kërkim të ushqimit. Dhe, në çast mu kujtua një moment kur isha në vitin e parë të shkollës së mesme... Aso kohe pata botuar vjershën e parë me titull "Pulëbardha, mbretëresha e zogjve". E, si një djalë që nuk e kisha ndërruar kurrë frizurën, jetoja me krenarinë për vjershën e botuar.

Aso kohe nënës sime i kishte thënë një e njohur jona se më donte.

E, nëna ime vetëm i kishte buzëqeshur dhe nuk i kishte thënë dot gjë.

Dhe, kur arrita në shtëpi, nëna më tha se filania... i kishte thënë se më donte mua. "A ke pasur guxim t'i thuash babait se e do?", i thashë nënës.

"Jo, s'kam pasur!", ma ktheu.

"Eh, e sheh ti, ajo ka guxim dhe të paska thënë se më do mua!", ia ktheva unë.

Dhe, e di se me kaq u përmbyllë ai kapitull i asaj kohe...

### SIMPATINË TIME MA "GRABITI"

#### PROFESORI NGA ULQINI!

Në Ferizaj dikur kishte shumë poetë, madje ekzistonte edhe grupi letrar "Jeronim de Rada", në të cilin edhe tuboheshim ne, të interesuarit.

Aty ndodhej edhe ajo, e cila i kishte thënë nënës sime se më donte mua...

Andaj edhe më kishte kapluar vala e syrit të saj, mua, djaloshin që zgjohesha me frizurën që ma krijonte natën jastëku ku flija. Dhe, në gjithë atë përpëlitje mendimesh, mu kujtua tash mu ajo, të cilën ma pat "grabitur" profesori nga Ulqini.

Ajo, aso kohe, mbaj mend, kishte sy si të gjarpurit...

E, mu ata sy më bëhej se i shihja tash, teksa rrezitesha në plazh...

Dhe, kur pa se unë veç isha tretur në mendime, mu afrua afër e më tha:

"Hy nën çadër se të djegë dielli!"

"Mirë e ke, sepse po të ndizem nuk më fik as deti!", ia ktheva.

"Dukesh i dëshpëruar?!", vazhdoi.

"Jo, as i lumtur e as i dëshpëruar! E, mesi qenka më i vështiri", ia ktheva.

Në moment ra heshtja. Ajo uli kokën dhe më la përshtypjen se me kaq përfundoi edhe ky "teatër". Dhe, në çast mendova se kishte të drejtë, sepse kush do të fliste me një budalla si unë, i cili në vend të fjalëve të bukura, shprehte dëshpërimin para një zonje si ajo...

"Ti ende i paske sytë e njëjtë!", foli pak ajo.

"E, ku m'i njeht ti sytë mua?!", ia ktheva me habi.

"Ti njoh, sepse unë jam ajo... ajo që më pat "rrëmbyer" profa i Ulqinit...", më tha me një qeshje të lehtë.

"Ti... ajo?!", belbëzova në vete.

"Po, po, vetë unë! 41 vjet e kam pritur këtë ditë, këtë takim...", më tha, duke ma shtrënguar dorën fort.

E, ai shtrëngim i dorës së saj më mbeti kujtimi më i mirë i jetës...

Luli, Ferizaj

tourist  
**CAMPING**



Adresa: Shtoj, Ulqin

[www.touristcamping.me](http://www.touristcamping.me)

Tel: +38269336233

 /giovanniscampingresort



**Giovanni's Beach**  
COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin

[www.touristcamping.me](http://www.touristcamping.me)

Tel: +38269825858

 /giovannis\_beach\_montenegro



# “Ka vite që nuk e kam prekur me dorë gruan time!”

*Gruan e kam të ndershme, por nuk ka aspak bukuri. Ka vite që nuk e kam prekur me dorë, sepse nuk po më tërheqë. Sidoqoftë, jam bërë njëfarë aventuristi, sepse po gjej femra që janë ndarë nga burrat dhe po kanë nevojë për seks...*

Jam 55-vjeçar, i martuar. Më martuan familja. Pranova të jetoj me gruan që ma sollën në shtëpi. Dhe, me të i lindëm dy fëmijët që i kemi. Gruan e kam të ndershme, punëtore, por nuk është e bukur. S'ka bukuri. E, unë jam bërë njëfarë aventuristi, sepse

po gjej femra që janë ndarë nga burrat dhe po kanë nevojë për seks...

## S'KAM INTIMITET ME GRUAN!

Ka vite që nuk fle me gruan, nuk kemi intimitet. Neveritem kur më ofrohet. Gjej ndonjë justifikim dhe kaloj të fle në dhomën e fëmijëve. Kam kërkuar të ndahemi, por ia nisi të qajë dhe ndarjen e lidhë me fëmijët. Andaj, para fëmijëve më duhet të aktroj sikur e dua shumë nënën e tyre...

## SI IU VARDISA SHOQES NË PUNË?

Sidoqoftë, para do vjetësh, meqë nuk kisha intimitet me gruan, iu vardisa një gruaje në punë, e cila kishte kohë që ishte ndarë nga burri. Ajo ishte e bukur, e dashur, krejt ndryshe nga gruaja ime. Dhe, që nga njohja me të ndihesha sikur jetoja prapë, e jo si deri atëherë. U bëra plotësisht njeri tjetër... Por, nuk shkoi shumë kohë dhe ajo pat një

ofertë për martesë dhe më la me gishta në gojë. Mirëpo, para se të martohej më njohu me një shoqe të saj, edhe ajo e ndarë nga burri.

Thënë të drejtën, shoqja e saj më pëlqeu edhe më shumë, ani pse ishte goxha e moshuar. Me rëndësi për mua ishte se ajo e mbante veten mirë, mendohej t'i imitonte zonjat...

Por, e keqja është se jam dashuruar në të dhe kur nuk jam pranë saj asgjë nuk më shkon mbarë!

Kam frikë se ndjenjën time ndaj saj do e kuptojnë fëmijët dhe familjarët e mi, e do më përbuzin pastaj.

Mirëpo, as nga dashnorja nuk mund të ndahem, sepse jam dashuruar marrëzisht. Është femra më e mirë që kam takuar dhe e dua jashtëzakonisht shumë. M'i lexon edhe mendimet, edhe lëvizjen e buzëve... Megjithatë, dua të marrë një vendim dhe të vendosi njëherë e përgjithmonë për të ardhmen time, sepse kështu jeta nuk po shkuaka dhe qenka jashtëzakonisht vështirë të jetosh me dikë që nuk e dashuron...

Fazliu, Ferizaj





# Revolucion në DOBËSIM

E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë. Rugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë. Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm. Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përbushur ëndrrat e tyre.



Perforco  
vaten



Detoksifikohu



Relaksohu



Balanco  
Shëndetin



PARA



PAS



PARA



PAS



PARA



PAS

Prishtinë

+383 45 224 540

Prizren

+383 43 900 902

Gjilan

+383 45 505 043

Gjakovë

+383 44 545 444

## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

*kontaktoni në këtë email adresë:*

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

### **Pse e dashura e la djalin tim?**

Përsëndetje zonja magjistare! Jam një nënë shumë e brengosur për djalin tim, i cili ishte në lidhje me një vajzë dhe lidhja e tyre funksiononte perfekt mirë. Por, papritmas janë ndarë...

A është e mundur që vajza nuk e do më djalin, kur ata ishin bashkë qe 4 vjet dhe ky ishte viti i pestë?

Çka ka ndodhur që ajo është larguar dhe me asnjë kusht më nuk do me qenë më me djalin tim?

Djali po vuan dhe nuk është i rrugëve të këqija, por ka qenë shumë i përkushtuar ndaj saj...

**“E. V.”**

### **Përgjigje:**

*Lidhja e tyre pa një fund që do ta kishte fejesën, i ka prishur gjërat.*

*Katër vjet pa fejesë, kanë qenë tepër. Megjithatë, gjërat dihen pse s’ka ndodhur fejesa:*

*Familja e vajzës nuk ka qenë në pajtim për një bashkim të tyre, për shkak të një zënke që kanë pasur dikur në kohë rinie baballarët, i vajzës dhe i djalit.*

*Gabimi i tyre është se duhet ta kuptojnë se “Fëmija të miqësojnë edhe me hasmin!”, thotë një thënie popullore.*

*Për momentin, vajza është nën presion të familjes për të hequr dorë nga djali, por ajo para Vitit të Ri do ta kërkojë djalin vetë dhe ata më nuk do të ndahen.*

*Pra, lërini gjërat ashtu siç janë dhe mos u ndërhyjni!*

*Vajza nuk ka mundësi ta harrojë djalin dhe kjo mjafton të jeni të qetë dhe të mos ndërmerrni veprime, sepse mund ta përkeqësoni gjendjen.*

### **Fati i munguar, a kam depresion?**

Jam një vajzë, 30-vjeçare, jetoj në Gjermani.

E dua një djalë me të cilin shihemi më shumë në vendin e punës.

Por, unë nuk jam e vendosur për askënd, sepse më duket kam depresion.

Dashurohem shpejt, e, pastaj, nuk mund t’i shkoj deri në fund asnjë mundësie.

Kam probleme me veten time, nuk jam e sigurt në rrugën që marrë! A kam depresion? Çka po ndodh me mua?

**“E hutuara”**

### **Përgjigje:**

*Ti ke pasur një lidhje disavjeçare me një djalë në Gjermani dhe, pastaj, jeni ndarë.*

*Keni pasur shpresa të martoheni, por shkaku i një kredie gjithçka është përmbysur...*

*Por, shpirti yt fle e pushon vetëm te ai...*

*E, për të qenë me dikë tjetër duhet kaluar kohë.*

*Tani për tani nuk shoh se je e gatshme për një lidhje të re, sepse truri dhe shpirti duhet të mësohen me një pamje të re dhe me një sjellje të re që do ta ketë personi që do ta gjesh.*

### **Jam duke bashkëjetuar me të fejuarin, pse mërzhiten prindërit e tij?**

Jam një vajzë 23-vjeçare, studente në Prishtinë. Jam nga Gjakova. Kam të dashur me të cilin jemi duke bashkëjetuar qe dy vjet. Kemi shpesh mosmarrëveshje, por e di se më do shumë.

Por, e kam një brengë, më thotë se mërzhiten prindërit e tij...

**“Pa shifër”**

### **Përgjigje:**

*Ju nuk e keni bërë zyrtare lidhjen tuaj. Nuk jeni fejuar. Duhet ta daloni fejesën dhe aktin e fejesës me një mbyllje në banesë me qira larg rrethit tuaj.*

*Fejesa është akt i zyrtarizimit të një lidhjeje. Është akt para martese.*

*Shtrohet pyetja: A ka diçka prej këtyre gjërave që ju keni ndër marrë meqë po bashkëjetoni?*

*Nuk ka asgjë. Askush mund të mos di për lidhjen tuaj. Jeni takuar në Prishtinë, jeni njohur, mund të flini bashkë në banesë derisa jenë studentë dhe në fund secili rrugës së vet!*

*Askush prej jush nuk ka të drejtë morale as ligjore të kërkojë prej palës tjetër llogari.*

*Bashkëjetesa është një jetë e shfrenuar, që e ka sjellë koha si dukuri të pape-shuar.*

*Ti atë djalë nuk e ke as të fejuar, as burrë. Po i shfrytëzoni ndjenjat e njëritjetrit për një kohë sa jeni në Prishtinë.*

*Prandaj, kanë arsye të mërzhiten prindërit e tij, por edhe prindërit tu. Sepse, sikur jeni ofruar edhe do të ndaheni...*

### **Ku e kam fatin?**

Përsëndetje zonja magjistare, jam një vajzë 26-vjeçare nga Prishtina. E kam kryer fakultetin, por nuk po gjej punë.

E dua një djalë. Emri i tij fillon me shkronjën M.

Si e sheh këtë lidhje dhe a do të martohemi?

**“Gjethi vjeshtor”**

### **Përgjigje:**

*Jeni në lidhje qe pesë vjet. Para tij ke pasur edhe dikë tjetër dhe ky është*

*problemi kryesor që ju shpesh grin-  
deni dhe pajtoheni...*

*Ju keni një pasiguri në këtë lidhje.  
Ai dyshon se ti mund të rikthehesh te  
i pari, ndërsa ti dyshon se ky do të të  
lërë shkaku i të parit.  
Megjithatë, do të bëheni bashkë. Do  
të martoheni.*

## **Pse nuk jemi askush rehat në familje?**

Përsëritet zonjë! Jam një zonjë nga Zvicra, nënë e tre fëmijëve. Kam stres dhe kokëdhimbje të vazhdueshme. Para disa vitesh më kanë humbur një palë veshje komplete dhe më nuk i kam gjetur kurrë.

Kam dyshim se më ka bërë ndokush magji.

Njëjtë kanë probleme edhe vajza dhe djali. Janë të heshtur, të mbyllur.

Çka po ndodhë në familjen time?

## **"Zonja nga Zvicra"**

### **Përgjigje:**

*Jeni familje me nervozë sa herë që jeni bashkë dhe kjo, zakonisht, vjen nga magjia.*

*Ty para do kohësh të ka humbur një komplet veshjesh dhe mundësia me të bërë dikush magji ekziston.*

*Edhe kokëdhimbja, në të shumtën e rasteve, vjen nga magjia dhe e njëjta mund ta përfshijë familjen.*

*Këtë mund ta shihni edhe te vajza e djali, që dalin shpesh nga kontrolli, si duke qëndruar mbyllur, ashtu edhe me pirje të shumtë të duhanit.*

*Por, problemi juaj është se nuk besoni në magji, e cila i kapur edhe profetët, madje, edhe pse kanë qenë shumë afër Zotit të madhërishtëm!*

### **Pse dështoj kur ndihem mirë?**

E dashura magjistare, kam një problem që mendoj se nuk e ka çdo kush. Kur e ndiej veten mirë, them me vete, gjithçka po ecë mirë. Por, edhe kur gëzohem shumë, fillon çdo gjë të merr teposhtzën!

Thuhet se fati vjen krejt papritur dhe ashtu më ka ndodhur edhe mua...

E njoha një djalë me të cilin çdo gjë

shkoi mirë dhe gjërat filluan të thellohen, duke shkuar mirë e më mirë. Por, ndërkohë atij i vdiq një shok i ngushtë dhe nga ajo kohë u ftohë ndaj meje!

Pra, mu në kohën kur isha shumë e lumtur më të, çdo gjë m'u kthye në dëshpërim!

Dua të di, a do të ketë hajër në këtë punë?

## **"Pa shifër"**

### **Përgjigje:**

*Është një thënie popullore, e dalë nga përvoja popullore: "Mos u gëzo i gëzuar, mos u hidhëro i hidhëruar!"*

*E, kjo thënie e koncepton dhe shpjegon më së miri këtë gjendje të ndryshimeve socio-psikike të njeriut, tek i cili ndodh kataklizëm praktik dhe shpirtëror, si në poezinë e arbëreshit Vorea Ujko, i cili për syzhe tematik ka tri motra që presin fatin...*

*Kur e pret e madhja fatin, që duhej të vinte në agim, po atë mëngjes vdiq papritur dhe ia ndërpreu misionin e pritjes së fatit.*

*Edhe motra e dytë njëjtë e kishte kërkuar fatin.*

*Dhe, në vend të fatit i troket vdekja e befasishme!*

*E, kur motra e vogël u ndikua nga kjo përvojë, duke pritur vdekjen në vend të fatit, ia behu fati dhe e bëri të lumtur...*

*Andaj, filozofia popullore rrjedh nga përvoja, ashtu sikur janë krijuar këngët popullore në luftë e në mjerim, në tragjedi e në mort.*

*Pra, ajo që krijohet në zjarr mbetet për t'u kënduar e jetuar.*

*E, në rastin tënd, ia vlen lufta për atë person që të ka dashur.*

*Ai që të ka dashur ka mundësi për të të dashur sërish...*

*Jeni të njëjtit, të cilët dashurinë e keni hedhur në aut, jashtë fushës së lojës, shkaku i vdekjes që ka pasur shoku i tij i ngushtë.*

*Andaj, ka mundësi të rikthehet te ti me plot dashuri, sepse me kohë do e kuptojë se nuk jetohet duke vuajtur dhe duke lotuar përjetësisht, meqë jeta vazhdon...*

## **PËR LEXUESIT E DIASPORËS**

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

### **Jetoj me dhimbjet e përditshme...**

Jam nënë, i kam dy fëmijë (22 dhe 20 vjeç), jetoj jashtë Kosovës.

Jetoj me një shqetësim të përditshëm, duke më dhimbtë çdo ditë diku.

Mjeku më thotë se nuk kam probleme shëndetësore. I kam bërë analizat sa e sa herë dhe çdo gjë më del mirë, e nuk ndihem mirë!

Fëmijët i kam në rrugë të mirë, nuk konsumojnë as duhan as alkool.

Pse e kam këtë problem, motër e nderuar?

## **"Kurbetçarja"**

### **Përgjigje:**

*Ti, në fakt, nuk e ke këtë problem sot e as prej sot, por kështu ke jetuar që nga fëmijëria.*

*De fakto, nuk je paciente, por nuk je edhe larg pacientes.*

*Nuk ke asnjë problem, por ke dhimbje që shkaktohet nga baza nervore psikiatrike, e që rrjedh nga e kaluara traumatike.*

*Traumatizmi nuk shërohet posa ta kalojë njeriu kufirin e BE-së. Brezat tanë jetojnë me trauma dhe kanë nevojë t'i shërojnë traumat.*

*Andaj, shkaku i traumave në botën kriminalistike ka shumë vrasës serikë, që kanë kryer dhe kryejnë krime të paarsyeshme...*

*Bota traumatike vazhdon te çdo kush, ku prindi i ka treguar diçka nga jeta e vet.*

*Nuk ka shekull që nuk ka ndodhur ndonjë luftë. E, lufta e ujitë tokën me gjak, ndërkaq nga gjaku krijohen legjenda dhe mite, që, pastaj, për t'i demitizuar duhet të kalojnë breza e breza...*

*Në rastin tënd, nuk bën punë mjekësia as jeta klinike, sepse kur je mirë me refleksione mjeko-laboratorike, barërat përjashtohen si zgjidhje.*

*Lufta të mbetet ty, andaj ka shërim alternativ...*

# Atë që përballon njeriu, guri s'e përballon!

*Të vjetrit, mbaj mend si fëmijë, thoshin: "Zoti ia lëshoi dhimbjen gurit e u ça, ia lëshoi dhimbjen drurit e u tha, ia lëshoi dhimbjen njeriut dhe e përballoi".*

Jam lindur e rritur në fshat, me kushtet dhe me mentalitetin e fshatit. E di që për rininë e sotshme shumë gjëra nga ato që u them janë budallallëqe, por kështu u rrit brezi im...

Në familjen e prindërve të mi kemi qenë katër djem e dy vajza. Kemi qenë ndër familjet që quheshim të pasur. Kishim tufë të madhe delesh, kishim shtëpinë dy kate, por nuk kishim titull beu.

Vëllai i madh, pasi mbaroi ushtrinë, u martua me një vajzë nga një fshat goxha i largët, që do të bëhej si motër për mua. Vëllai i dytë, pasi erdhi nga ushtria, u përpoq t'u ikte punëve të fshatit, andaj gjeti punë në minierën e boksitit, afër Klinës. Dhe, fati deshi që në atë rajon njohu një vajzë nga familje e mirë dhe u martua me të e jetuan atje.

Vëllai i tretë ka punuar në ndërtimtari. Edhe ai nusen e kishte nga fshati, një engjëll.

Vëllai i vogël, i llastuari, jetoi në fshat me prindërit, edhe pse vetë punonte në qytet. Por, e keqja ishte se kthehej vonë në shtëpi dhe gjithmonë ekzistonte frika se mund t'i ndodhë ndonjë e keqe nga regjimi i kohës...

## SI U ZHDIK MOTRA PA PRITË E KUJTUAR?!

Motra e vogël një mbrëmje nuk u kthye në shtëpi. E kërkua kudo rreth lumit, por kot.

Dhimbja në shtëpinë tonë ishte e tmerrshme...

Thënë të drejtën, nëna ime sa herë që e kapte mërzia për vajzën e zhdukur, e ofendonte nusen që e kishim në shtëpi, thuajse ajo ishte shkaktare e zhdukjes së motrës sonë...

E, unë, në fakt, i dilja krah nuses, sepse ajo e gjora s'kishte gisht në zhdukjen e motrës sonë, e as që kishte qenë me të atë ditë që ajo më nuk u kthye në shtëpi.

E, meqë ia mbaja krahun kur e ofendonin, ajo nisi të ofrohej edhe më shumë me mua, aq sa një ditë më tha: "Dëshiron të bëhesh grua e vëllait tim?".

Në ato çaste stepa, u shtanga, sepse kurrnjëherë nuk e kisha pritur një gjë të tillë...

Kështu, ajo u bë sebeb që unë u martova me vëllanë e saj.

Dhe, me tim burrë kam kaluar gjithë jetën

mirë, por e kam pasur një kunatë beqare që ma ka nxirë jetën në maksimum. Unë linda pesë fëmijë. Kur u rritën dy djem e dy vajza i martova dhe isha e kënaqur me martesat e tyre.

Djali i madh i kishte tre fëmijë, e djali tjetër e kishte një djalë e nusen shtatzënë në muajin e pestë, kur ndodhi gjëma që në familjen time vazhdon akoma. Ndërsa im bir kthehej nga puna, vetura e tij aksidentohet dhe ai vdes në vend. Ishte gushti i vitit 1998, kohë kur në disa pjesë të Kosovës veç kishte filluar lufta. Dhimbja ishte shumë e madhe...

## DHIMBJA S'KISHTE FUND...

Dhimbja na rritej edhe më shumë kur mendonim se si do të rriteshin dy engjëjt që la pas.

Nusja vendosi të mos kthehej te prindërit dhe t'i rriste fëmijët te ne, edhe pse mbeti pa burrë shumë e re.

Por, njeriu nuk po vdiqte pse kishte jetë të vështirë. Ai po i duronte të gjitha...

Të vjetrit, mbaj mend si fëmijë, thoshin: "Zoti ia lëshoi dhimbjen gurit e u ça, ia lëshoi dhimbjen drurit e u tha, ia lëshoi dhimbjen njeriut dhe e përballoi". Kështu, edhe unë, të gjitha deri më tani i durova...

E si, e di shpirti im!

Gjylsime D.



# DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE